REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

| Pranuar - Primljeno Më/Dana 01. 07. 2024 vit.god. | | | |
|---|---|---|---|
| Nr.i organit Org.broj | Numri/Broj | Shtojcë Prilog | Vlera Vrednost |
| 01 - | 110 | 05 - | 925 |

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality Viti/na

Kuvendi i Komunës së Vitisë, në bazë të nenit 12, shkronja d të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 17, pika 2, lidhur me neni 6, paragrafi I, pika 1.1, të Ligit me Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës (Gazeta Zyrtare Nr.10, prill 2019), kërkesa e Ministrisë për Administrim të Pushtetit Lokal me Nr.020-370/3, e datës 21.06.2024, nenit 36, paragrafi 36.2, shkronja d, neni 40, 41, shkronja a të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur më datën 29.05.2024 miraton këtë:

# V E N D I M

**për plotësim ndryshim të Vendimit me Nr.01-110/05-834, i datës 31.05.2024 për formimin e komisionit vlerësues dhe zbatimin e procedurave për dhënien e pronës paluajtshme të komunës tek shtëpia e kulturës "Gursel e Bajram Sylejmani" në shfrytëzim afatëshkurt prej 13 viteve**

**Neni 1**

Me këtë Kuvendi i Komunës së Vitisë miraton vendimin për plotësim ndryshim të Vendimit me Nr.01-110/05-834, i datës 31.05.2024 për formimin e komisionit vlerësues dhe zbatimin e procedurave për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës tek shtëpia e kulturës "Gursel e Bajram Sylejmani" në shfrytëzim afatëshkurt prej 13 viteve.

**Neni 2**

Konform neni 1 të këtij vendimi, plotësim ndryshimi bëhet tek kohëzgjatja e shfrytëzimit afatëshkurt prej 13 viteve bëhet në 15 vite, bazuar në kërkesen e Ministrisë për Administrim të Pushtetit Lokal me Nr.020-370/3, e datës 21.06.2024.

**Neni 3**

Të gjitha pjesët tjera të vendimit bazë mbeten në fuqi.

**Neni 4**

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, në kuptim të nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 8, lidhur me neni 9 të Rregullores Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të akteve të komunave dhe pas publikimit në web faqen e Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:
1. Zyrës së Kryetarit;
2. Anëtarve të komisionit;
3. MAPL-së; dhe
4. Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË
K R Y E S U E S I
Bekim Azizi